



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.1245/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit Raiffesien Bank Kosovë, me seli në Prishtinë, rr. “Robert Doll”, nr.99, kundër debitorit M.Z. – N.Sh., që të dy me adresë në Pidiq, Komuna e Gjilanit dhe N.P.T. “Dritoni” me seli në fshatin Pidiq, Komuna e Gjilanit, të cilin e përfaqëson H I.Z., për shkak të borxhit, në bazë të marrëveshjes mbi pengun, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorëve, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, CPK.nr.82/2022 i datës 26.09.2022, më datën 01.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e debitorëve N.Sh. dhe N.P.T. “Dritoni”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, CPK.nr.82/2022 i datës 26.09.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar, CPK.nr.82/2022 i datës 26.09.2022, në pikën I të dispozitivit e ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm të debitorit M.Z.- i ndjerë, për procedurën përmbartimore P.nr. 185/22, ë cila zhvillohet te Përmbartuesi Privat Sefer Sh. Arifi në Gjilan. Përfaqësuesi i përkohshëm caktohet N.Sh. (bashkëshortja e të ndjerit), e cila ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesit të ligjshëm deri në përfundim të procedurës përmbartimore, në pikën II të dispozitivit ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e datës 29.04.2022 të debitorit të tretë “N.T.T Dritoni”, i paraqitur kundër Urdhërit Përmbartimor P.nr. 185/22 të datës 20.04.2022 të Përmbartuesit Privat Sefer Sh. Arifi nga Gjilani dhe i njëjti urdhër mbete në fuqi.

Kundër aktvendimit të lartcekur brenda afatit ligjor ka ushtruar debitori për shkak të: të zbatimit te gabuar të së drejtës materiale, shkeljes së dispozitave, vërtetimi të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë të aprovoj si të bazuar ankesën kreditorit, dhe ta prishë aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, CPK.nr.82/2022 i datës 26.09.2022, si dhe ta shfuqizohej urdhrin për lejimin e përmbartimit P.nr. 185/22 të datës 20.04.2022.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur kreditorit, duke propozuar që të refuzohet ankesa e debitorëve si të pa bazuar dhe të vërtetoj aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, CPK.nr.82/2022 i datës 26.09.2022.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

- Ankesa e debitori është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Teb Sh.A., ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorëve debitorëve Nerxhivane dhe N.P.T. "Dritoni", në bazë të mbi bazën e dokumentit: Marrëveshje mbi Kredinë nr.200705488, me kamatëvonese që do të arrijë në pagesën definitive duke propozuar që Përmbaruesi Privat të nxjerrë Urdhër Përmbarimor me të cilin lejohet përmbarimi për pagesën e borxhit të përgjithshëm prej 2,473.00€, deri në përmbushjen definitive të detyrimit të debitorëve ndaj kreditorit.

Përmbaruesi Privat Sefer Sh. Arifi me seli në Gjilan, me Urdhrin Përmbarimor P.nr. 185/22 të datës 20.04.2022, ka caktuar përmbarimin, duke vlerësuar se dokumentet përmbarimore të lartcekura, i plotësojnë kushtet për përmbarim.

Ndaj këtij urdhri ka paraqitur prapësim debitori, duke propozuar që të anulohet urdhri për përmbarim P.nr. 185/22 të datës 20.04.2022, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Sefer Sh. Arifi me seli në Gjilan dhe të abrogohen të gjitha veprimet përmbarimore të ndërmarra lidhur me propozimin për përmbarim të dt. 20.04.2022.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditorit, duke i cilësuar pretendimet e debitorit si të pa bazuara dhe përpjekje për zvarritjen e procedurës së përmbarimit, me propozim që Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, CPK.nr.82/2022 i datës 26.09.2022, prapësimin e debitorit të pa bazuar dhe të pa argumentuar ligjërisht, dhe të konfirmoj-vërtetoj urdhrin përmbarimor P.nr. 1197/21, i datës 27.08.2021 nga Përmbaruesi Privat I Sefer Sh. Arifi me seli në Gjilan me të cilin është lejuar përmbarimi për kredinë e debitorëve të lartshënuar.

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar, CPK.nr.82/2022 i datës 26.09.2022, në pikën I të dispozitivit e ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm të debitorit M.Z.- i ndjerë, për procedurën përmbarimore P.nr. 185/22, ë cila zhvillohet te Përmbaruesi Privat Sefer Sh. Arifi në Gjilan. Përfaqësuesi i përkohshëm caktohet N.Sh. (bashkëshortja e të ndjerit), e cila ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesit të ligjshëm deri në përfundim të procedurës përmbarimore, në pikën II të dispozitivit ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e datës 29.04.2022 të debitorit të tretë "N.T.T Dritoni", i paraqitur kundër Urdhërit Përmbarimor P.nr. 185/22 të datës 20.04.2022 të Përmbaruesit Privat Sefer Sh. Arifi nga Gjilani dhe i njëjti urdhër mbettë në fuqi.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, ka se erdhi në përfundim që nuk u kontestua fakti se debitori M.Z. ka vdekur, andaj duke u bazuar në nenin 35, paragrafi 4 te Ligjit për Procedurën Përmbarimore "*Gjykata mund të emerjojë vetëm një person që nuk ka interes personal në konflikt me interesat e debitorit, dhe përfaqësuesi i përkohshëm ka për detyre që të veproje në interes të debitorit*", vendosi që t'i caktojë përfaqësues të përkohshëm debitorit të caktoj N.Sh. - bashkëshortja e të ndjerit' dhe e detyroi të veproje në interes të tij deri në përfundimin e kësaj procedure përmbarimore, e cila njëkohësisht është edhe debitore e dyte në këtë lëndë, mirëpo meqenëse e njejta nuk ka konflikt me interesat e debitorit të ndjere, por kane interesa të njejta, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit. Gjykata, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që debitori nuk ka vërtetuar asnjërin nga shkaqet të cilat janë parapare në nenin 71 të LPP-se lidhur me besueshmërinë e prapësimit. Pretendimin e debitorit të tretë, se sendet të cilat janë lënë peng sipas listës së pengut të datës 15.12.2016, duhet të përjashtohen

nga përmbartimi, konform nenit 85 paragrafi 1.3 te LPP-ës, gjykata e konsideron si pretendim të pabazuar, kjo për shkak se këto sende janë lënë peng me vullnetin e lirë të tani debitorëve, konkretisht debitorit të parë tashmë të ndjerë dhe debitorit të tretë, i cili në marrëveshjen mbi kredinë ka cilësinë e garantuesit? dhe se në nenin 3 të Marrëveshjes mbi kredinë nr. 200705488 është përcaktuar se "Qëllimi i kësaj kredie është që të financohet blerja e bagëtive dhe renovimi i fermës" andaj edhe sendet e sipërcituara janë lënë peng për realizimin e këtij qëllimi, dhe me nenin 85 par.2 te LPP-ës është përcaktuar se "Dispozitat nga nën paragrafi 1.3. paragrafi 1. i këtij neni nuk vlejnë për përmbartim të realizimit të kërkesave monetare te bankave.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm vlerësimin dhe qëndrimin juridik të Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Debitori, në ankesën e ushtruar ka theksuar gjykata me rastin e marrjes së aktvendimit të ankimuar ka bërë vlerësimin të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike, gjegjësisht dispozitave të LPP-së, për shkak se nuk ka vlerësuar drejtë dhe nuk i ka marrë parasysh fare pretendimet e debitorit të parashtruara me ankesë dhe urdhërin përmbartimor. Gjykata ka për detyrë të përpiket që procedurën të zhvilloj pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzimet, si dhe të bëjë pamundur cdo shpërdorim të së drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji, gjithashtu të gjitha sendet e luajtshme të cila debitori i ka lënë peng duke përfshirë: Viqa, sanën, kashtë, lopën, traktorin, laktofriz, freza duhet të përjashtohen nga përmbartimi pasi që gjithë këto mjete dhe kafshë janë për kryerjen e aktivitet dhe zanatit për të fituar të ardhura minimale. Andaj propozojmë që të ankesa e debitori të aprovohet dhe lënda të rikthehet në rivendosje.

Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë pretendimet ankimore te debitorit i vlerëson si të bazuara dhe të pa qëndrueshme, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se në pikën I të dispozitivit e ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm të debitorit M.Z.- i ndjerë, për procedurën përmbartimore P.nr. 185/22, e cila zhvillohet te Përmbartuesi Privat Sefer Sh. Arifi në Gjilan. Përfaqësuesi i përkohshëm caktohet N.Sh. (bashkëshortja e të ndjerit), e cila ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesit të ligjshëm deri në përfundim të procedurës përmbartimore, në pikën II të dispozitivit ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e datës 29.04.2022 të debitorit të tretë “N.T.T Dritoni”, i paraqitur kundër Urdhërit Përmbartimor P.nr. 185/22 të datës 20.04.2022 të Përmbartuesit Privat Sefer Sh. Arifi nga Gjilani dhe i njëjti urdhër mbettë në fuqi. Gjykat ka ardhur në që nuk u kontestua fakti se debitori M.Z. ka vdekur, andaj duke u bazuar në nenin 35, paragrafi 4 te Ligjit për Procedurën Përmbartimore *"Gjykata mund të emerjojë vetëm një person që nuk ka interes personal në konflikt me interesat e debitorit, dhe përfaqësuesi i përkohshëm ka për detyrë që të veproje në interes të debitorit"*, vendosi që t'i caktojë për përfaqësues të përkohshëm debitorit të caktoj N.Sh. - bashkëshortja e të ndjerit' dhe e detyroi të veproje në interes të tij deri në përfundimin e kësaj procedure përmbartimore, e cila njëkohësisht është edhe debitore e dYTE në këtë lëndë, mirëpo meqenëse e njëjta nuk ka konflikt me interesat e debitorit të ndjere, por kane interesa të njëjta, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit. Gjykata, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që debitori nuk ka vërtetuar asnjërin nga shkaqet të cilat janë parapare në nenin 71 të LPP-se lidhur me besueshmërinë e prapësimit. Pretendimin e debitorit të tretë, se sendet të cilat janë lënë peng sipas listës së pengut të datës 15.12.2016, duhet të përjashtohen nga përmbartimi, konform nenit 85 paragrafi 1.3 te LPP-ës, gjykata e konsideron si pretendim të pabazuar, kjo për shkak se këto sende janë lënë peng me vullnetin

e lirë të tani debitorëve, konkretisht debitorit të parë tashmë të ndjerë dhe debitorit të tretë, i cili në marrëveshjen mbi kredinë ka cilësinë e garantuesit? dhe se në nenin 3 të Marrëveshjes mbi kredinë nr. 200705488 është përcaktuar se "Qëllimi i kësaj kredie është që të financohet blerja e bagëtive dhe renovimi i fermës" andaj edhe sendet e sipërcituara janë lënë peng për realizimin e këtij qëllimi, dhe me nenin 85 par.2 të LPP-ës është përcaktuar se "Dispozitat nga nën paragrafi 1.3. paragrafi 1. i këtij neni nuk vlejnë për përmbarrim të realizimit të kërkesave monetare të bankave, në bazë të huave për zhvillimin e bujqësisë, respektivisht zanatit, me kushtë që ky kushtë është deklaruar në mënyrë të veçante në kontratën për hua, ku shprehimisht parashihet sipas nenin 83 par.1 pika 1.3 që në rastin konkret u vërtetuar se kredia dhe sendet janë lënë në pengë me qëllim financimi dhe blerje e bagëtive dhe renovimin e fermës dhe rrjedhimisht nuk hynë në kategorinë e sendeve të cila i nënshtrohen përjashtimit nga përmbarrimi, andaj u vendos me të drejtë si në pikën II të dispozitivit nga Gjykata Themelore në Gjiilan-Departamenti i Përgjithshëm me aktvendim CPK.nr.82/22 të datës 26.09.2022.

Me nenin 22 par.1 pika 1.7 të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore përcaktohet se "1. Dokumentet përmbarruese janë: 1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit". Ndërsa me dispozitën ligjore nga neni 5 par.2 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, përcaktohet se "Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas nën-paragrafit 1.7., shtohet nën-paragrafi i ri 1.7a. me tekstin si në vijim. 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut". Andaj, me këtë rast, Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ke refuzuar si të pabazuar prapësimin e datës 29.04.2022 të debitorit të tretë NTT "Dritoni", të paraqitur kundër urdhrin përmbarrimore P.nr.185/22 të dt.20.04.2022, për arsye se propozimi për përmbarrim është paraqitur në bazë të Marrëveshjes mbi Kredinë me Nr.200705488, e cila marrëveshjen në bazë të dispozitave 21 dhe 22 të LPP-së, që në këtë rast përbënë bazë për caktimin e përmbarrimit.

Duke u mbështetur në nenin 69 par.4 të LPP "baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet", me çka debitori nuk ka ofruar ndonjë provë për të vërtetuar të kundërtën e kreditorit, por edhe pretendimet e vetë debitorit në prapësim. Prandaj, sipas vlerësimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, pretendimet ankimore të debitorit nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ngase me nenin 21 të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore përcaktohet se "Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër", ngase një pretendim i tillë, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarrimit në këtë rast.

Andaj, duke marrë parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore. Andaj, me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit të parashtruar kundër Urdhrit Përmbarrimor P.nr.185/22, i datës 20.04.2022.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e shkallës së dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.1245/23 dt. 01.03.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami